

LIGJ
Nr.9802, datë 13.9.2007

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NDËRKOMBËTARE TË OKB-SË “PËR MBROJTJEN
E TË GJITHË PERSONAVE NGA ZHDUKJET ME FORCË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa Ndërkombëtare e OKB-së “Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë”, bërë në Paris më 20 dhjetor 2006.

Neni 2

Në zbatim të nenit 31 të kësaj Konvente, Republika e Shqipërisë deklaron se njeh kompetencën e Komitetit të Zhdukjeve me Forcë, për të pranuar dhe shqyrtuar komunikimet e paraqitura nga personat ose për llogari të personave, në juridiksionin e tij, të cilët ankohen se janë viktimat të shkeljes së dispozitave të kësaj Konvente nga shteti shqiptar.

Neni 3

Në zbatim të nenit 32 të kësaj Konvente, Republika e Shqipërisë deklaron se njeh kompetencën e Komitetit të Zhdukjeve me Forcë, për të pranuar dhe shqyrtuar komunikimet, ndërmjet të cilave një shtet palë pretendon se një shtet tjetër palë nuk i përmbush detyrimet e veta, sipas Konventës.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5462, datë 19.9.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTA NDËRKOMBËTARE
E OKB-SË PËR MBROJTJEN E TË GJITHË PERSONAVE
NGA ZHDUKJET ME FORCË

HYRJE

Shtetet Palë të kësaj Konvente:

duke pasur parasysh se Karta e Kombeve të Bashkuara i detyron Shtetet të promovojnë respektimin universal dhe efektiv të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore;

duke u mbështetur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;

duke kujtuar Paktin Ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, Paktin Ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare përkatëse në fushat e të drejtave të njeriut, të të drejtës humanitare dhe të të drejtës penale ndërkombëtare;

duke kujtuar, gjithashtu deklaratën mbi mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në rezolutën e saj 47/133 të datës 18 dhjetor 1992;

të ndërgjegjshëm për rrezikshmërinë ekstreme të zhdukjes me forcë, që përbën një krim dhe, në disa rrethana të përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare, një krim kundër njerëzimit;

të vendosur për të parandaluar zhdukjet me forcë dhe për të luftuar kundër mosndëshkimit të krimit të zhdukjes me forcë;

duke mbajtur parasysh të drejtën e çdo njeriu për të mos u bërë subjekt i një zhdukjeje me forcë dhe të drejtën e viktimave për drejtësi e për dëmshpërblim;

duke afirmuar të drejtën e çdo viktime për të njohur të vërtetën mbi rrethanat e një zhdukjeje me forcë dhe për të mësuar mbi fatin e personit të zhdukur, si dhe të drejtën e lirisë për të mbledhur, marrë dhe shpërndarë informacione për këtë qëllim,

kanë rënë dakord mbi nenet në vijim:

PJESA E PARË

Neni 1

1. Askush nuk do të jetë subjekt i një zhdukjeje me forcë.

2. Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdolloji, qoftë gjendje lufte a rrezik lufte, paqëndrueshmëri e brendshme politike ose çdo lloj tjetër gjendjeje e jashtëzakonshme, nuk mund të nxirret si justifikim për një zhdukje me forcë.

Neni 2

Për qëllime të kësaj Konvente, me “zhdukje me forcë” do të kuptohet arrestimi, burgosja, rrëmbimi ose çdo formë tjetër heqjeje lirie nga agjentë të shtetit apo nga persona të tjerë a grupe personash, që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, pasuar nga mohimi i pranimin të heqjes së lirisë ose nga fshehja e fatit të personit të zhdukur a e vendit ku gjendet ai, duke e shpëputur nga mbrojtja e ligjit.

Neni 3

Çdo Shtet Palë merr masat e duhura për të hetuar mbi veprimet e përcaktuara në nenin 2, që janë vepër e personave a grupeve të personave, që veprojnë pa autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit dhe për t'i vënë përgjegjësit para drejtësisë.

Neni 4

Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme në mënyrë që zhdukja me forcë të përbëjë një vepër penale, sipas të drejtës së tij penale.

Neni 5

Ushtrimi i përgjithësuar ose sistematik i zhdukjes me forcë përbën një krim kundër njerëzimit, ashtu siç përcaktohet nga e drejta ndërkombëtare e zbatueshme dhe sjell pasojat e parashikuara nga kjo e drejtë.

Neni 6

Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për të quajtur penalisht përgjegjës më së pakti:

a) Çdo person që kryen një zhdukje me forcë, e urdhëron ose e porosit atë, tenton ta kryejë, është bashkëfajtor ose merr pjesë në të;

b) Eprorin që:

i) kishte dijeni që vartës të vendosur nën autoritetin dhe kontrollin e tij efektiv po kryenin ose do të kryenin një krim zhdukjeje me forcë, ose nuk ka marrë parasysh me ndërgjegje të dhëna që e tregonin qartë;

ii) ushtronte përgjegjësinë dhe kontrollin e tij efektiv mbi veprimtaritë me të cilat ishte lidhur krimi i zhdukjes me forcë; dhe

iii) nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme që ishin në kompetencën e tij për të penguar ose ndëshkuar porositjen e një zhdukjeje me forcë, ose për t'ia dërguar çështjen autoriteteve kompetente për qëllime hetimi a ndjekjeje;

c) Nënparagrafi b më sipër nuk prek normat më të larta të përgjegjësisë të zbatueshme në të drejtën penale ndërkombëtare ndaj një komandanti ushtarak a një personi që kryen efektivisht funksionin e komandantit ushtarak.

2. Asnjë urdhër a udhëzim, që vjen nga një autoritet publik, civil, ushtarak a tjetër nuk mund të përdoret për të justifikuar një krim të zhdukjes me forcë.

Neni 7

1. Çdo Shtet Palë e bën krimin e zhdukjes me forcë të ndëshkueshëm me dënimet e përshtatshme që marrin parasysh shkallën e tij ekstreme të rrezikshmërisë.

2. Çdo Shtet Palë mund të parashikojë:

a) Rrethana lehtësuese, veçanërisht në favor të atyre që, të implikuar në kryerjen e një zhdukjeje me forcë, kanë kontribuar në mënyrë të efektshme për shpëtimin e jetës së personit të zhdukur ose kanë bërë të mundur të ndriçohen raste të zhdukjes me forcë, ose të identifikohen autorët e një zhdukjeje me forcë;

b) Pa prekur procedurat e tjera penale, rrethana rënduese, veçanërisht në rast vdekjeje të personit të zhdukur ose për ata që janë bërë fajtorë për zhdukjen me forcë të grave shtatzëna, të të miturve, të personave handikapatë, ose të personave të tjerë veçanërisht të prekshëm.

Neni 8

Pa prekur nenin 5,

1. Çdo Shtet Palë që zbaton një regjim të parashkrimit të zhdukjes me forcë merr masat e nevojshme në mënyrë që afati i parashkrimit të ndjekjes penale:

a) Të jetë afatgjatë dhe në proporcion me rrezikshmërinë ekstreme të këtij krimi;

b) Të fillojë nga momenti kur pushon krimi i zhdukjes me forcë, duke marrë parasysh karakterin e tij të vazhduar.

2. Çdo Shtet Palë garanton të drejtën e viktimave të zhdukjes me forcë për një rekurs efektiv gjatë periudhës së parashkrimit.

Neni 9

1. Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për të vendosur kompetencën e tij për qëllime të njohjes së një krimi të zhdukjes me forcë:

a) Kur vepra është kryer në çdo territor nën juridiksionin e tij ose në bordin e avionëve, apo anijeve të regjistruara në këtë shtet;

b) Kur autori i dyshuar i veprës është një shtetas i tij;

c) Kur personi i zhdukur është një shtetas i tij dhe Shteti Palë e konsideron të tillë.

2. Çdo Shtet Palë merr, gjithashtu masat e nevojshme për të vendosur kompetencën e tij për qëllime të njohjes së një krimi të zhdukjes me forcë, kur autori i dyshuar i veprës ndodhet në çdo territor nën juridiksionin e tij, përveç rastit kur shteti në fjalë e ekstradon ose ia dorëzon atë një shteti tjetër, në përputhje me detyrimet e tij ndërkombëtare ose me një juridiksion penal ndërkombëtar të cilit ky ia ka njohur kompetencën.

Neni 10

1. Nëse e çmon se rrethanat e justifikojnë, pasi ka shqyrtuar të dhënat që disponon, çdo Shtet

Palë në territorin e të cilit ndodhet një person i dyshuar se ka kryer një krim të zhdukjes me forcë, siguron burgosjen e këtij personi ose merr të gjitha masat e tjera juridike të nevojshme për t'u siguruar për praninë e tij. Kjo burgosje dhe këto masa duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e Shtetit Palë në fjalë; ato mund të zbatohen vetëm gjatë afatit të nevojshëm për t'u siguruar për praninë e tij gjatë procedurave penale, atyre të dorëzimit apo të ekstradimit.

2. Shteti Palë që ka marrë masat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni kryen menjëherë një hetim paraprak apo hetime me qëllim që të përcaktojë faktet. Ai informon Shtetet Palë të përmendur në paragrafin 1 të nenit 9 për masat që ka marrë, në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, duke përfshirë burgosjen dhe rrethanat që e justifikojnë atë, dhe për përfundimet e hetimit paraprak apo të hetimeve të tij, duke u treguar nëse ka për qëllim të ushtrojë kompetencën e tij.

3. Çdo person i burgosur në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni mund të komunikojë menjëherë me përfaqësuesin më të afërt të përshtatshëm të shtetit të kombësisë së tij ose, kur është fjala për një person pa atdhe, me përfaqësuesin e shtetit ku ai banon zakonisht.

Neni 11

1. Shteti Palë në territorin e juridiksionit të të cilit është zbuluar autori i dyshuar i një krimi të zhdukjes me forcë, nëse nuk e ekstradon këtë të fundit, ose nuk ia dorëzon një shteti tjetër, në përputhje me detyrimet e tij ndërkombëtare ose një juridiksioni penal ndërkombëtar kompetencën e të cilit e ka njohur, ua nënshton çështjen autoriteteve të tij kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale.

2. Këto autoritete marrin vendimin e tyre në të njëjtat kushte, si për çdo krim tjetër ordiner të karakterit të rëndë, sipas të drejtës së këtij Shteti Palë. Në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 9, rregullat e provës që zbatohen për ndjekjet dhe për dënimin nuk janë në asnjë mënyrë më pak rigoroze sesa ato që zbatohen në rastet e parashikuara në paragrafin 1 të nenit në fjalë.

3. Çdo person i ndjekur në lidhje me një krim të zhdukjes me forcë, gëzon garancinë e një trajtimi të drejtë në të gjitha fazat e procedurës. Çdo person i gjykuar për një krim të zhdukjes me forcë, përfiton nga një proces i drejtë para një trupi gjykues a gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj.

Neni 12

1. Çdo Shtet Palë i siguron cilitdo që pretendon se një person ka qenë viktimë e një zhdukjeje me forcë, të drejtën për të denoncuar faktet para autoriteteve kompetente, të cilat e shqyrtojnë me shpejtësi dhe me paanësi akuzën dhe, nëse është rasti, ndërmarrin pa vonesë një hetim të thelluar dhe të paanshëm. Nëse është rasti, merren masat e duhura për të siguruar mbrojtjen e paditësit, të dëshmitarëve, të afërmeve të personit të zhdukur dhe të mbrojtësve të tyre, si dhe të atyre që marrin pjesë në hetim, ndaj çdo keqtrajtimi apo çdo frikësimi për shkak të padisë së ngritur ose çdo deponimi të bërë.

2. Kur ekzistojnë motive të arsyeshme për të besuar se një person ka qenë viktimë e një zhdukjeje me forcë, autoritetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni hapin një hetim, edhe nëse asnjë padi nuk është ngritur zyrtarisht.

3. Çdo Shtet Palë kujdeset që autoritetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni:

a) Të kenë kompetencat dhe burimet e nevojshme për të kryer siç duhet hetimin, përfshi këtu aksesin në dokumentacionin dhe informacionet e tjera, që lidhen me hetimin e tyre;

b) Të kenë akses, nëse është e nevojshme, me autorizimin paraprak të një juridiksioni që e merr këtë vendim sa më shpejt që të jetë e mundur, në çdo vend burgimi dhe në çdo vend tjetër ku ka motive të arsyeshme për të besuar se gjendet personi i zhdukur.

4. Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për të parandaluar dhe sanksionuar aktet që pengojnë zhvillimin e hetimit. Ai sigurohet, veçanërisht, që personat e dyshuar se kanë kryer një krim të zhdukjes me forcë të mos jenë në gjendje të ndikojnë në zhvillimin e hetimit me presione apo veprime frikësimi apo reprezalje të ushtruara mbi paditësin, dëshmitarët, të afërmit e personave të zhdukur dhe mbrojtësve të tyre, si dhe mbi ata që marrin pjesë në hetim.

Neni 13

1. Për nevojat e ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë, krimi i zhdukjes me forcë nuk konsiderohet si krim politik, krim i lidhur me një krim politik ose krim i frymëzuar nga qëllime politike. Për rrjedhim, një kërkesë ekstradimi, e bazuar mbi një krim të tillë, nuk mund të refuzohet për këtë motiv të vetëm.

2. Krimi i zhdukjes me forcë është i përfshirë me të drejtë në numrin e krimeve që justifikojnë ekstradimin në çdo traktat ekstradimi, të nënshkruar ndërmjet Shteteve Palë para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

3. Shtetet Palë angazhohen ta përfshijnë krimin e zhdukjes me forcë në numrin e krimeve që e justifikojnë ekstradimin në çdo traktat ekstradimi, që do të nënshkruhet në vijim ndërmjet tyre.

4. Çdo Shtet Palë që ia nënshtron ekstradimin ekzistencës së një traktati mundet, nëse merr një kërkesë ekstradimi të një Shteti tjetër Palë me të cilin nuk është i lidhur me ndonjë traktat, ta konsiderojë këtë Konventë si bazë juridike për ekstradimin, përsa i përket krimit të zhdukjes me forcë.

5. Shtetet Palë që nuk ia nënshtrojnë ekstradimin ekzistencës së një traktati, e njohin krimin e zhdukjes me forcë si krim të ekstradueshëm ndërmjet tyre.

6. Ekstradimi, në çdo rast, i nënshtrohet kushteve të parashikuara nga e drejta e Shtetit Palë, të cilit i bëhet kërkesa ose nga traktatet e ekstradimit të zbatueshëm, duke përfshirë këtu, veçanërisht, kushtet në lidhje me dënimin minimal të kërkuar për ekstradim dhe motivet për të cilat Shteti Palë të cilit i bëhet kërkesa mund ta refuzojë ekstradimin apo t'ia nënshtrojë atë disa kushteve.

7. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk duhet të interpretohet si detyruese për Shtetin Palë, të cilit i kërkohet të ekstradojë, nëse ka arsye serioze për të menduar që kërkesa është paraqitur me qëllim ndjekjen apo dënimin e një personi për shkak të seksit, racës, fesë, kombësisë, origjinës etnike, opinioneve politike apo të përkatësisë së tij në një grup shoqëror, ose që dhënia rrugë e kësaj kërkesë do ta dëmtonte këtë person për njërin prej këtyre arsyeve.

Neni 14

1. Shtetet Palë i japin njëri-tjetrit ndihmën juridike reciproke më të madhe të mundshme në çdo procedurë penale, që lidhet me një krim të zhdukjes me forcë, duke përfshirë atë që ka të bëjë me komunikimin e të gjitha elementeve të provës që ata disponojnë dhe që janë të nevojshëm për qëllimet e procedurës.

2. Kjo ndihmë juridike e ndërsjellë i nënshtrohet kushteve të parashikuara nga e drejta e brendshme e Shtetit Palë të cilit i kërkohet ose nga traktatet e ndihmës së ndërsjellë të zbatueshme, duke përfshirë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me motivet për të cilat Shteti Palë të cilit i kërkohet mund të refuzojë të japë ndihmë juridike të ndërsjellë ose t'ia nënshtrojë këtë disa kushteve.

Neni 15

Shtetet Palë bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe i japin njëri-tjetrit ndihmën e ndërsjellë më të madhe të mundshme për t'u ardhur në ndihmë viktimave të zhdukjeve me forcë, si dhe në kërkimin, lokalizimin dhe lirin e personave të zhdukur dhe, në rast vdekjeje, në zhvarrimin, identifikimin e personave të zhdukur dhe rikthimin e trupave të tyre.

Neni 16

1. Asnjë Shtet Palë nuk do ta përzërë, nuk do ta kthejë, nuk do ta dorëzojë, as nuk do ta ekstradojë një person drejt një shteti tjetër, nëse ka arsye serioze për të besuar se ky rrezikon të jetë viktimë e një zhdukjeje me forcë.

2. Për të përcaktuar, nëse ka arsye të tilla, autoritetet kompetente mbajnë parasysh të gjitha konsideratat përkatëse, përfshi këtu, kur është rasti, ekzistencën në shtetin në fjalë, të një sërë dhunimesh sistematike të rënda, flagrante apo masive të të drejtave të njeriut ose dhunimesh të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Neni 17

1. Askush nuk do të mbahet i burgosur në fshehtësi.
2. Pa prekur detyrimet e tjera ndërkombëtare të Shtetit Palë në fushën e heqjes së lirisë, çdo Shtet Palë në legjislacionin e tij:
 - a) Përcakton kushtet në të cilat mund të jepen urdhrat për heqjen e lirisë;
 - b) Cakton autoritetet që kanë të drejtë të urdhërojnë heqjen e lirisë;
 - c) Garanton që çdo person të cilit i hiqet liria do të vendoset vetëm në vende të heqjes së lirisë, të njohura dhe të kontrolluara zyrtarisht;
 - d) Garanton që çdo person të cilit i hiqet liria të jetë i autorizuar të komunikojë me familjen e tij, këshilltarin e çdo person tjetër që dëshiron dhe të vizitohet prej tyre, me rezervën e vetme të kushteve të vendosura nga ligji, dhe, nëse është fjala për një të huaj, të komunikojë me autoritetet konsullore, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme;
 - e) Garanton aksesin në vendet e heqjes së lirisë të çdo autoriteti dhe institucioni kompetent të autorizuar nga ligji, nëse është e nevojshme me autorizimin paraprak të një autoriteti gjyqësor;
 - f) I garanton çdo personi të cilit i është hequr liria dhe, në rast dyshimi për zhdukje me forcë, ku personi të cilit i është hequr liria gjendet në pamundësi për ta ushtruar vetë, çdo personi që ka një interes të ligjshëm, për shembull të afërmeve të personit të cilit i është hequr liria, përfaqësuesve apo avokatëve të tyre, në çdo rrethanë, të drejtën për të apeluar para një gjykate me qëllim që ajo të vendosë në një kohë sa më të shkurtër mbi legjitimitetin e heqjes së lirisë dhe të urdhërojë lirimin, nëse kjo heqje lirie është e paligjshme.
3. Çdo Shtet Palë do të sigurojë hartimin dhe përditësimin e një apo më shumë regjistrave zyrtarë dhe/ose dosjeve zyrtare për personat të cilëve u është hequr liria, që, me kërkesën e tyre, do të vihen menjëherë në dispozicion të çdo autoriteti gjyqësor ose çdo autoriteti apo institucioni kompetent të autorizuar, nga legjislacioni i Shtetit Palë të interesuar apo nga çdo instrument juridik ndërkombëtar përkatës në të cilin shteti i interesuar bën pjesë. Ndërmjet të dhënave do të figurojnë të paktën:
 - a) Identiteti i personit të cilit i është hequr liria;
 - b) Data, ora dhe vendi ku personit i është hequr liria dhe autoriteti që ka proceduar në heqjen e lirisë;
 - c) Autoriteti që ka vendosur heqjen e lirisë dhe arsyet e heqjes së lirisë;
 - d) Autoriteti që kontrollon heqjen e lirisë;
 - e) Vendi i heqjes së lirisë, data dhe ora e pranimin në vendin e privimit nga liria dhe autoriteti përgjegjës i vendit të privimit nga liria;
 - f) Elementet që lidhen me gjendjen shëndetësore të personit të cilit i është hequr liria;
 - g) Në rast vdekjeje gjatë heqjes së lirisë, rrethanat dhe shkaqet e vdekjes dhe destinacioni i trupit të personit të vdekur;
 - h) Data dhe ora e lirimit ose transferimit drejt një vendi tjetër të privimit nga liria, destinacioni dhe autoriteti i ngarkuar me transferimin.

Neni 18

1. Nën rezervën e neneve 19 dhe 20, çdo Shtet Palë i garanton çdo personi që ka një interes legjitim për këtë informacion, për shembull të afërmeve të personit të cilit i është hequr liria, përfaqësuesve apo avokatëve të tyre, të ketë akses të paktën në informacionet në vijim:
 - a) Autoriteti që ka vendosur heqjen e lirisë;
 - b) Data, ora dhe vendi i heqjes së lirisë dhe e pranimin në vendin e privimit nga liria;
 - c) Autoriteti që kontrollon heqjen e lirisë;
 - d) Vendi ku ndodhet personi të cilit i është hequr liria, duke përfshirë, në rast transferimi drejt një vendi tjetër të privimit nga liria, destinacionin dhe autoritetin përgjegjës për transferimin;
 - e) Data, ora dhe vendi i lirimit;
 - f) Elementet që lidhen me gjendjen shëndetësore të personit të cilit i është hequr liria;
 - g) Në rast vdekjeje gjatë heqjes së lirisë, rrethanat dhe shkaqet e vdekjes dhe destinacioni i trupit të personit të vdekur.

2. Kur është rasti, do të merren masat e duhura për të siguruar mbrojtjen e personave të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe të atyre që marrin pjesë në hetim, ndaj çdo keqtrajtimi, çdo frikësimi apo çdo sanksion, për shkak të kërimit të informacionit në lidhje me personin të cilit i është hequr liria.

Neni 19

1. Informacionet personale, duke përfshirë të dhënat mjekësore ose gjenetike që janë mbledhur dhe/ose transmetuar në kuadrin e kërimit të një personi të zhdukur nuk mund të përdoren apo të vihen në dispozicion për qëllime të tjera, përveç atyre të kërimit të personit të zhdukur. Kjo nuk prek përdorimin e këtyre të dhënave në procedurat penale që lidhen me një krim të zhdukjes me forcë dhe të ushtrimit të së drejtës për të marrë dëmshpërblim.

2. Mbledhja, trajtimi, përdorimi dhe ruajtja e informacioneve personale, përfshi këtu të dhënat mjekësore apo gjenetike, nuk duhet të shkelin ose të kenë si pasojë shkeljen e të drejtave të njeriut, të lirive themelore dhe dinjitetit të qenies njerëzore.

Neni 20

1. Vetëm në rastin kur një person është nën mbrojtjen e ligjit dhe kur heqja e lirisë është nën kontroll gjyqësor, e drejta për informacionet e parashikuara nga neni 18 mund të kufizohet në mënyrë të jashtëzakonshme, në minimumin e nevojshëm që e kërkon situata ose e parashikon ligji dhe nëse transmetimi i informacioneve prek jetën private apo sigurinë e personit apo pengon zhvillimin si duhet të një hetimi kriminal, ose për arsye të tjera ekuivalente të parashikuara nga ligji, dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme dhe me qëllimet e kësaj Konvente. Në asnjë rast këto kufizime të së drejtës për informacione, të parashikuara në nenin 18 nuk mund të pranohen, nëse përbëjnë një sjellje të përcaktuar në nenin 2 ose një shkelje të paragrafit 1 të nenit 17.

2. Pa prekur shqyrtimin e ligjshmërisë së heqjes së lirisë së një personi, Shteti Palë u garanton personave të përmendur në paragrafin 1 të nenit 18 të drejtën e një rekursi gjyqësor, të shpejtë dhe të efektshëm, për të marrë në një afat të shkurtër informacionet e parashikuara në këtë paragraf. Kjo e drejtë për rekurs nuk mund të pezullohet apo të kufizohet në asnjë rrethanë.

Neni 21

Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme që rikthimi i lirisë një personi të kryhet sipas modaliteteve që lejojnë të verifikohet me siguri që ai është liruar efektivisht. Çdo Shtet Palë merr gjithashtu masat e nevojshme për t'i siguruar çdo personi në momentin e lirim të integritetin fizik dhe ushtrimin e plotë të të drejtave të tij, pa prekur detyrimet të cilave mund t'i nënshtrohet sipas ligjit kombëtar.

Neni 22

Pa prekur nenin 6, çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për të parandaluar dhe sanksionuar veprimet në vijim:

a) Pengimi ose bllokimi i rekurseve të parashikuara në nënparagrafin f) të paragrafit 2 të nenit 17 dhe të paragrafit 2 të nenit 20;

b) Mosplotësimi i detyrimit të regjistrimit të çdo heqjeje lirie, si dhe mosregjistrimi i çdo informacioni të cilit nëpunësi përgjegjës i regjistrit zyrtar i ka njohur ose duhet t'i kishte njohur pasaktësinë;

c) Refuzimi për të dhënë informacione mbi një heqje lirie ose dhënia e informacioneve të pasakta, ndërkohë që ekzistojnë kushtet ligjore për dhënien e këtyre informacioneve.

Neni 23

1. Çdo Shtet Palë kujdeset që formimi i personelit ushtarak ose civil të ngarkuar për zbatimin e ligjit, i personelit mjekësor, i nëpunësve të funksionit publik dhe i personave të tjerë, që mund të ndërhyjnë në ruajtjen ose trajtimin e çdo personi të privuar nga liria të mund të përfshijë mësimin dhe

informacionin e nevojshëm në lidhje me dispozitat përkatëse të kësaj Konvente, me qëllim që:

- a) Të parandalohet implikimi i këtyre nëpunësve në zhdukjet me forcë;
- b) Të theksohet rëndësia e parandalimit dhe hetimeve në fushën e zhdukjeve me forcë;
- c) Të kihet kujdes që të njihet urgjenca e vendimeve në rastet e zhdukjeve me forcë.

2. Çdo Shtet Palë kujdeset që të ndalohen urdhrat apo udhëzimet që porosisin, autorizojnë ose inkurajojnë një zhdukje me forcë. Çdo Shtet Palë garanton që një person që refuzon t'i bindet një urdhri të tillë do të sanksionohet.

3. Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme në mënyrë që personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, që kanë arsye të mendojnë se ka ndodhur ose është përgatitur një zhdukje me forcë, t'ia njoftojnë rastin eprorëve të tyre dhe, nëse është e nevojshme, autoriteteve apo instancave kompetente të kontrollit apo të rekursit.

Neni 24

1. Për qëllime të kësaj Konvente me “viktimë” kuptohet personi i zhdukur dhe çdo person fizik që ka pësuar një dëmtim direkt nga fakti i një zhdukjeje me forcë.

2. Çdo viktimë ka të drejtë të dijë të vërtetën mbi rrethanat e zhdukjes me forcë, zhvillimin dhe rezultatet e hetimit dhe fatin e personit të zhdukur. Çdo Shtet Palë merr masat e duhura në lidhje me këtë.

3. Çdo Shtet Palë merr të gjitha masat e duhura për kërkimin, lokalizimin dhe lirimin e personave të zhdukur dhe, në rast vdekjeje, për lokalizimin, respektimin dhe kthimin e trupave të tyre.

4. Çdo Shtet Palë i garanton, në sistemin e tij juridik, viktimës së një zhdukjeje me forcë të drejtën për të marrë dëmshpërblim dhe për t'u zhdëmtuar shpejt, në mënyrë të drejtë dhe të përshtatshme.

5. E drejta për të marrë dëmshpërblim, e parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni mbulon dëmtimet materiale dhe morale, si dhe, kur është rasti, forma të tjera dëmshpërblimi të tilla si:

- a) Kthimi;
- b) Ripërshtatja;
- c) Kënaqësia, përfshi këtu rivendosja e dinjitetit dhe e reputacionit;
- d) Garanci për mospërsëritje.

6. Pa prekur detyrimin e vijimit të hetimit deri në sqarimin e fatit të personit të zhdukur, çdo Shtet Palë merr masat e duhura në lidhje me gjendjen ligjore të personave të zhdukur, fati i të cilëve nuk është sqaruar dhe të të afërmeve të tyre, veçanërisht në fusha të tilla si mbrojtja sociale, çështjet financiare, e drejta e familjes dhe të drejtat e pronësisë.

7. Çdo Shtet Palë garanton të drejtën për të krijuar organizata dhe shoqata që kanë si qëllim të kontribuojnë në sqarimin e rrethanave të zhdukjes me forcë dhe të fatit të personave të zhdukur, si dhe në asistencën ndaj viktimave të zhdukjes me forcë dhe të marrë pjesë lirisht në organizata apo shoqata të tilla.

Neni 25

1. Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për të parandaluar dhe dënuar penalisht:

a) Marrjen e fëmijëve subjekt i një zhdukjeje me forcë ose fëmijëve, babai, nëna ose përfaqësuesi ligjor i të cilëve është bërë subjekt i një zhdukjeje me forcë, ose fëmijëve të lindur gjatë mbajtjes rob të nënës së tyre subjekt i një zhdukjeje me forcë;

b) Falsifikimin, fshehjen ose shkatërrimin e dokumenteve që vërtetojnë identitetin e vërtetë të fëmijëve të përmendur në nënparagrafin a) më sipër.

2. Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për të kërkuar dhe identifikuar fëmijët e përmendur në nënparagrafin a) të paragrafit 1 të këtij neni dhe për t'ua kthyer familjeve të tyre të origjinës, në përputhje me procedurat ligjore dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme.

3. Shtetet Palë i japin reciprokisht njëri-tjetrit asistencë për kërkimin dhe identifikimin e fëmijëve të përmendur në nënparagrafin a) të paragrafit 1 të këtij neni, si dhe për përcaktimin e vendit ku ata ndodhen.

4. Duke mbajtur parasysh nevojën për të ruajtur interesin më të lartë të fëmijëve të përmendur në nënparagrafin a) të paragrafit 1 të këtij neni dhe të drejtën e tyre për të ruajtur dhe për të rivendosur identitetin e tyre, duke përfshirë kombësinë, mbiemrin dhe lidhjet e tyre familjare të njohura nga ligji,

në Shtetet Palë që e njohin sistemin e adoptimit ose forma të tjera të vendosjes së fëmijëve, duhet të ekzistojnë procedura ligjore që kanë për qëllim të rishikojnë procedurën e adoptimit apo vendosjes së fëmijëve dhe, kur është rasti, të anulojnë çdo adoptim apo vendosje të fëmijëve që ka si origjinë një zhdukje me forcë.

5. Në çdo rrethanë, dhe në veçanti për gjithçka që ka të bëjë me këtë nen, interesi më i lartë i fëmijës është synimi parësor dhe fëmija që është në gjendje të gjykojë ka të drejtë të shprehë lirshëm opinionin e tij, i cili merret në konsideratë rregullisht duke pasur parasysh moshën e tij dhe shkallën e tij të pjekurisë.

PJESA E DYTË

Neni 26

1. Për vënien në zbatim të dispozitave të kësaj Konvente, krijohet një Komitet i zhdukjeve me forcë (i quajtur në vijim “Komiteti”), i përbërë nga dhjetë ekspertë me moral të lartë, që zotërojnë aftësi të njohura në fushën e të drejtave të njeriut, të pavarur, me seli personale dhe që veprojnë në paanësi të plotë. Anëtarët e Komitetit do të zgjidhen nga Shtetet Palë sipas një shpërndarjeje të drejtë gjeografike. Do të merret parasysh interesi që paraqet pjesëmarrja në punët e Komitetit e personave që kanë një përvojë juridike të përshtatshme dhe shpërndarja e ekuilibruar ndërmjet burrave dhe grave në gjirin e këtij Komiteti.

2. Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë nga një listë kandidatësh të caktuar nga Shtetet Palë ndërmjet shtetasve të tyre, gjatë mbledhjeve të përdyvitshme të Shteteve Palë, të mbledhura për këtë qëllim nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, ku kuorumi i nevojshëm përbëhet nga dy të tretat e Shteteve Palë, do të zgjidhen anëtarë të Komitetit ata kandidatë që fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të përfaqësuesve të Shteteve Palë të pranishëm dhe votues.

3. Zgjedhjet e para do të zhvillohen e shumta gjashtë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara u dërgon një letër Shteteve Palë për t’i ftuar që të paraqesin kandidatura brenda një afati prej tre muajsh. Sekretari i Përgjithshëm harton listën alfabetike të kandidatëve të caktuar në këtë mënyrë, duke treguar për çdo kandidat Shtetin Palë që e paraqet. Ai ua komunikon këtë listë të gjitha Shteteve Palë.

4. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një periudhë katërvjeçare. Ata mund të rizgjidhen një herë. Megjithatë, mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur gjatë zgjedhjeve të para merr fund pas dy vjetësh; menjëherë pas zgjedhjeve të para, emrat e pesë personave hidhen në short nga kryetari i mbledhjes së përmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

5. Nëse një anëtar i Komitetit vdes, jep dorëheqjen nga funksionet e tij ose nuk është më në gjendje për ndonjë arsye tjetër të përmbushë detyrat e tij në Komitet, Shteti Palë që e ka caktuar emëron, sipas kriteve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, një kandidat tjetër shtetas të tij që të shërbejë në Komitet për pjesën e mandatit që mbetet, por nën rezervën e miratimit nga shumica e Shteteve Palë. Ky miratim konsiderohet si i marrë, në rast se të paktën gjysma e Shteteve Palë ose më shumë, nuk shprehin opinion të pafavorshëm në një afat prej gjashtë javësh duke filluar nga momenti kur këto janë informuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për emërimin e propozuar.

6. Komiteti vendos rregulloren e tij të brendshme.

7. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara vë në dispozicion të Komitetit personelin dhe mjetet materiale të nevojshme për kryerjen me efikasitet të funksioneve të tij. Sekretari i Përgjithshëm thërret anëtarët e Komitetit për mbledhjen e parë.

8. Anëtarët e Komitetit gëzojnë lehtësitë, privilegjet dhe imunitetet që u njihen ekspertëve në mision për Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ashtu siç përmenden në seksionet përkatëse të Konventës mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara.

9. Çdo Shtet Palë angazhohet të bashkëpunojë me Komitetin dhe të ndihmojë anëtarët e tij në ushtrimin e mandatit të tyre, në kufijtë e funksionit të Komitetit që ai i ka pranuar.

Neni 27

Një konferencë e shteteve anëtare do të mbledhet më së pakti katër vjet dhe më së shumti gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për të vlerësuar funksionimin e Komitetit dhe për të vendosur, sipas modaliteteve të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 44, nëse ka vend t'i besohet ndonjë instance tjetër, pa përjashtuar asnjë eventualitet, ndjekja e kësaj Konvente me atributet e përcaktuara në nenet 28 deri në 36.

Neni 28

1. Në kuadrin e kompetencave që i jep kjo Konventë, Komiteti bashkëpunon me të gjitha organet, zyrat, institucionet e specializuara dhe fondet e përshtatshme të Kombeve të Bashkuara, komitetet konvencionale të krijuara nga instrumentet ndërkombëtare, procedurat e veçanta të Kombeve të Bashkuara, organizatat ose institucionet rajonale ndërqeveritare të interesuara, si dhe me të gjitha institucionet, agjencitë dhe zyrat kombëtare përkatëse që punojnë për mbrojtjen e të gjithë personave kundër zhdukjeve me forcë.

2. Në kuadrin e funksioneve të tij, Komiteti konsulton komitete të tjera konvencionale të krijuara nga instrumentet përkatëse të të drejtave të njeriut, në veçanti Komitetin e të drejtave të njeriut të krijuar nga Pakti Ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike, më qëllim sigurimin e koherencës së vërejtjeve të tyre dhe rekomandimeve përkatëse.

Neni 29

1. Çdo Shtet Palë i paraqet Komitetit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, një raport mbi masat që ka marrë për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Konvente, në një afat prej dy vjetësh duke filluar nga hyrja në fuqi e Konventës për Shtetin Palë të interesuar.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara e vë raportin në dispozicion të të gjitha Shteteve Palë.

3. Çdo raport studiohet nga Komiteti, i cili mund të bëjë komente, vërejtje ose të japë rekomandimet që i vlerëson të përshtatshme. Shtetit Palë në fjalë i komunikohen komentet, vërejtjet ose rekomandimet, të cilave mund t'u përgjigjet, me iniciativën e tij ose me kërkesë të Komitetit.

4. Komiteti, gjithashtu mund t'u kërkojë Shteteve Palë të dhëna plotësuese mbi vënien në zbatim të kësaj Konvente.

Neni 30

1. Komitetit mund t'i drejtohet, me urgjencë, nga të afërmit e një personi të zhdukur, përfaqësuesit e tyre ligjorë, avokatët e tyre ose çdo person i mandatuar prej tyre, si dhe çdo person tjetër që ka një interes legjitim, një kërkesë që ka për qëllim të kërkojë dhe të gjejë një person të zhdukur.

2. Nëse Komiteti çmon se kërkesa e veprimit me urgjencë e paraqitur sipas paragrafit 1 të këtij neni:

- a) nuk është dukshëm e pabazuar;
- b) nuk përbën një abuzim me të drejtën për të paraqitur kërkesa të tilla;
- c) i është paraqitur paraprakisht dhe rregullisht organeve kompetente të Shtetit Palë të interesuar, të tilla si autoritetet që kanë të drejtë për të kryer hetime, kur ekziston një mundësi e tillë;
- d) nuk është në mospërputhje me dispozitat e kësaj Konvente; dhe
- e) nuk është tashmë në shqyrtim e sipër nga një instancë tjetër ndërkombëtare ose rregullore e së njëjtës natyrë,

ai i kërkon Shtetit Palë të interesuar t'i paraqesë, brenda një afati që e cakton ai, të dhëna mbi gjendjen e personit të kërkuar.

3. Nën dritën e informacioneve të dhëna nga Shteti Palë i interesuar, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Komiteti mund t'i transmetojë Shtetit Palë rekomandime duke përfshirë një kërkesë për të marrë të gjitha masat e nevojshme, përfshi ato të përkohshme, për të lokalizuar dhe për të mbrojtur personin e kërkuar në përputhje me këtë Konventë dhe për ta informuar Komitetin, brenda një afati të përcaktuar, mbi masat që ka marrë, duke pasur parasysh urgjencën e situatës. Komiteti e informon personin që ka parashtruar kërkesën e veprimit urgjent për rekomandimet e tij dhe

informacionet që i janë transmetuar nga Shteti Palë, kur këto janë të disponueshme.

4. Komiteti i vazhdon përpjekjet e tij për të punuar me Shtetin Palë të interesuar për atë kohë sa fati i personit të kërkuar nuk është sqaruar. Ai e mban në dijeni personin që ka paraqitur kërkesën.

Neni 31

1. Çdo Shtet Palë mund të deklarojë, në momentin e ratifikimit të kësaj Konvente ose më vonë, se e njeh kompetencën e Komitetit për të pranuar dhe shqyrtuar komunikime të paraqitura nga persona ose për llogari të personave nën juridiksionin e tij që ankohen se janë viktimë të një shkeljeje nga ky Shtet Palë, i dispozitave të kësaj Konvente. Komiteti nuk pranon asnjë komunikim që ka të bëjë me një Shtet Palë, që nuk e ka bërë një deklaratë të tillë.

2. Komiteti e deklaron të papranueshëm çdo komunikim nëse:

a) ai është anonim;
b) përbën një abuzim me të drejtën për të paraqitur komunikime të tilla ose është në mospërputhje me dispozitat e kësaj Konvente;
c) është në shqyrtim e sipër nga një instancë tjetër ndërkombëtare ose rregullore e së njëjtës natyrë; ose

d) nëse nuk janë shteruar të gjitha rekursat e brendshme efikase, që janë në dispozicion. Ky rregull nuk zbatohet nëse procedurat e rekursit i tejkalojnë afatet e arsyeshme.

3. Nëse Komiteti e gjykon se komunikimi i përgjigjet kushteve të kërkuara në paragrafin 2 të këtij neni, ai ia transmeton komunikimin Shtetit Palë të interesuar, duke i kërkuar të paraqesë, brenda një afati të caktuar prej tij, vërejtjet ose komentet.

4. Pas marrjes së një komunikimi dhe para se të marrë një vendim mbi thelbin, Komiteti mund në çdo çast t'i parashtrijë vëmendjes urgjente të Shtetit Palë të interesuar një kërkesë, me qëllim që ai të marrë masat e përkohshme të nevojshme, për të shmangur që një dëm i pandreqshëm t'u shkaktohet viktimave të dhunimit të supozuar. Ushtrimi, nga ana e Komitetit, i kësaj kompetence, nuk paragjykon pranueshmërinë ose shqyrtimin në thelb të komunikimit.

5. Komiteti mblidhet me detyrë të mbyllura kur shqyrton komunikimet e parashikuara në këtë nen. Ai e informon autorin e komunikimit mbi përgjigjet e dhëna nga Shteti Palë i interesuar. Kur Komiteti vendos ta finalizojë procedurën, ai ia komunikon konstatimet e tij Shtetit Palë dhe autorit të komunikimit.

Neni 32

Çdo Shtet Palë i kësaj Konvente mund të deklarojë, në çdo moment, se e njeh kompetencën e Komitetit për të pranuar dhe për të shqyrtuar komunikime, nëpërmjet të cilave një Shtet Palë pretendon se një Shtet tjetër Palë nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj Konvente. Komiteti nuk pranon asnjë komunikim që ka të bëjë me një Shtet Palë që nuk e ka bërë një deklaratë të tillë, si dhe asnjë komunikim që vjen nga një Shtet Palë që nuk e ka bërë një deklaratë të tillë.

Neni 33

1. Nëse Komiteti merr të dhëna të besueshme se një Shtet Palë po i shkel rëndë dispozitat e kësaj Konvente, pasi është konsultuar me Shtetin Palë të interesuar, ai mund t'u kërkojë një a më shumë anëtarëve të tij të kryejnë një vizitë dhe ta informojnë pa vonesë.

2. Komiteti e njofton me shkrim Shtetin Palë të interesuar mbi qëllimin e tij për të kryer një vizitë, duke treguar përbërjen e delegacionit dhe qëllimin e vizitës. Shteti Palë jep përgjigjen e tij brenda një afati të arsyeshëm.

3. Me kërkesën e motivuar të Shtetit Palë, Komiteti mund të vendosë ta shtyjë ose ta anulojë vizitën e tij.

4. Nëse Shteti Palë jep miratimin e tij për vizitën, Komiteti dhe Shteti Palë i interesuar bashkëpunojnë për të përcaktuar modalitetet e vizitës dhe Shteti Palë i siguron Komitetit të gjitha lehtësitë e nevojshme për kryerjen e kësaj vizite.

5. Në vijim të vizitës, Komiteti i komunikon Shtetit Palë të interesuar vërejtjet dhe rekomandimet e tij.

Neni 34

Nëse Komiteti merr informacione që i duket se përmbajnë të dhëna të bazuara, sipas të cilave zhdukja me forcë është ushtruar në mënyrë të përgjithësuar ose sistematike në territorin që është nën juridiksionin e një Shteti Palë, dhe pasi ka kërkuar pranë Shtetit Palë të interesuar çdo informacion të duhur mbi këtë situatë, ai mund ta sjellë me urgjencë çështjen në vëmendje të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 35

1. Komiteti ka kompetencë vetëm në lidhje me zhdukjet me forcë që kanë filluar pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Nëse një shtet bëhet Palë e kësaj Konvente pas hyrjes në fuqi të saj, detyrimet e tij ndaj Komitetit do të lidhen vetëm me zhdukjet me forcë, që kanë nisur pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në këtë Shtet.

Neni 36

1. Komiteti u paraqet Shteteve Palë dhe Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara një raport vjetor mbi veprimtaritë që ka ndërmarrë në zbatim të kësaj Konvente.

2. Botimi, në raportin vjetor, i një vërejtjeje që ka të bëjë me një Shtet Palë duhet t'i njoftohet paraprakisht Shtetit Palë të interesuar, që ka në dispozicion një afat të arsyeshëm për t'u përgjigjur dhe që mund të kërkojë botimin e komenteve apo vërejtjeve të tij në raport.

PJESA E TRETË

Neni 37

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do të prejë dispozitat më të favorshme për mbrojtjen e çdo personi nga zhdukjet me forcë që mund të figurojnë:

- a) Në legjislacionin e një Shteti Palë; ose
- b) Në të drejtën ndërkombëtare në fuqi për këtë Shtet.

Neni 38

1. Kjo Konventë është e hapur për t'u nënshkruar nga çdo shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit nga çdo shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës.

3. Kjo Konventë është e hapur për aderim për çdo shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Aderimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës.

Neni 39

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të instrumentit të njëzetë të ratifikimit apo të aderimit.

2. Për çdo shtet, që do ta ratifikojë këtë Konventë ose do të aderojë në të pas depozitimit të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose të aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga ky Shtet të instrumentit të tij të ratifikimit apo të aderimit.

Neni 40

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'i njoftojë të gjitha shtetet anëtare të Organizatës dhe të gjitha shtetet që e kanë nënshkruar këtë Konventë ose kanë aderuar në të për sa vijon:

- a) Nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet e marra në zbatim të nenit 38;
- b) Datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në zbatim të nenit 39.

Neni 41

Dispozitat e kësaj Konvente zbatohen, pa asnjë kufizim a përjashtim, në të gjitha njësitë konstitutive të shteteve federale.

Neni 42

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Shtetesh Palë në lidhje me interpretimin e kësaj Konvente që nuk zgjidhet me bisedime ose nëpërmjet procedurave të parashikuara shprehimisht në këtë Konventë, do t'i nënshtrohet arbitrazhit, me kërkesën e njërit prej tyre. Nëse, në gjashtë muajt që pasojnë datën e kërkesës për arbitrazh, Palët nuk arrijnë të bien dakord mbi organizimin e arbitrazhit, secila prej tyre mund t'ia nënshtrojë mosmarrëveshjen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, duke depozituar një padi në përputhje me Statutin e Gjykatës.

2. Çdo Shtet Palë do të mund, në momentin e nënshkrimit të kësaj Konvente, e ratifikimit apo aderimit në të, të deklarojë që nuk e konsideron veten të detyruar nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni. Shtetet e tjera Palë nuk do të jenë të lidhura nga këto dispozita ndaj shtetit që ka formuluar një deklaratë të tillë.

3. Çdo Shtet Palë që ka formuluar një deklaratë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni ka mundësi, në çdo moment, ta tërheqë këtë deklaratë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 43

Kjo Konventë nuk i prek dispozitat e të drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë detyrimet e palëve të larta kontraktuese të katër konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe të dy protokolleve shtesë të 8 qershorit 1977 në lidhje me to, as mundësinë që ka çdo shtet për të autorizuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq të vizitojë vendet e burgimit në rastet e paparashikuara nga e drejta humanitare ndërkombëtare.

Neni 44

1. Çdo Shtet Palë i kësaj Konvente mund të propozojë një amendament dhe ta depozitojë propozimin e tij pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua komunikon propozimin e amendamentit Shteteve Palë të kësaj Konvente duke u kërkuar ta vënë në dijeni, nëse janë në favor të organizimit të një konference të Shteteve Palë, me qëllim shqyrtimin e propozimit dhe hedhjen e tij në votë. Në rast se, në katër muajt që pasojnë datën e një komunikimi të tillë, të paktën një e treta e Shteteve Palë shprehet në favor të mbajtjes së konferencës në fjalë, Sekretari i Përgjithshëm organizon konferencën nën kujdesin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Çdo amendament i miratuar me shumicën e dy të tretave të Shteteve Palë të pranishme dhe votuese në konferencë do t'i paraqitet për miratim të gjitha Shteteve Palë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Një amendament i miratuar sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi kur dy të tretat e Shteteve Palë të kësaj Konvente e kanë pranuar, në përputhje me procedurën e parashikuar nga kushtetutat e tyre përgjegjëse.

4. Kur amendamentet hyjnë në fuqi, ato janë të detyrueshme për Shtetet Palë që i kanë pranuar, ndërsa Shtetet e tjera Palë mbeten të lidhura nga dispozitat e kësaj Konvente dhe nga çdo amendament i mëparshëm që ato kanë pranuar.

Neni 45

1. Kjo Konventë, tekstet në anglisht, arabisht, kinezisht, spanjisht, frëngjisht dhe rusisht të së cilës kanë të njëjtën vlerë, do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'u japë nga një kopje të vërtetuar të kësaj Konvente të gjitha Shteteve të përmendura në nenin 38.